



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 04 22 68 141; 22 68 142

Nr. 329/3 Prot.

Tiranë, më 19.07.2017

V E N D I M

Nr. 170, datë 19.07.2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 177, datë 30.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Shkodër"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 177, datë 30.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Shkodër", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VËREJ SE:

Me Vendimin Nr.7, datë 18.01.2016, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në njësinë e qeverisjes vendore, Bashkia Shkodër", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka filluar procesi i mbikëqyrjes së përgjithshme në Bashkinë Shkodër. Ky proces është përmbyllur me Vendimin Nr. 177, datë 30.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Shkodër", në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në subjektin, Bashkia Shkodër, si pjesë përbërëse e këtij vendimi, si dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar ligjshmërinë sipas detyrave që do të detajohen në vijim.

2. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër të anulojë aktin nr. 106, datë 30.06.2014, me të cilin punonjësja ***** është konfirmuar “nëpunës civil” në pozicionin e punës ”Përgjegjës i Sektorit Juridik”, duke e ndryshuar statusin e saj nga nëpunës civil në “nëpunës civil në periudhë prove” dhe të kujdeset për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ligji dhe aktet nënligjore në lidhje me periudhën e provës.
3. Të kërkoj nga njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër anulimin e akteve administrative për konfirmimin si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës, të cilët në mënyrë analitike dhe sipas pozicioneve renditen si më poshtë:
 - ✓ aktin nr. 111, datë 30.03.2014, me të cilin punonjësja ***** është konfirmuar në kategorinë “nëpunës civil” në pozicionin ”Jurist, Drejtoria Juridike”;
 - ✓ aktin nr. 127, datë 30.06.2014, për konfirmimin në kategorinë “nëpunës civil”, në pozicionin e punës “Specialist i Infrastrukturës Nëntoksore”, të nëpunësit *****;
 - ✓ aktin nr. 132, datë 30.06.2014, të konfirmimit në kategorinë “nëpunës civil” në pozicionin e punës “Specialist Strehimi”, të nëpunëses *****.

Në zbatim të përcaktimeve të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, duhet të shtyhet periudha e provës për nëpunësit e mësipërm dhe vlerësimi për konfirmimin e tyre, duhet të bëhet pasi të përfundohet me sukses trajnimi i detyrueshëm në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).

4. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Shkodër, të anulojë aktet e deklaramit të statusit të punësimit, për punonjësit që ushtrojnë detyrat e tyre, në pozicione pune të cilat nuk përfshihen në fushën e shërbimit civil, si më poshtë vijon:
 - ✓ Aktin e deklaramit nr. 115, datë 30.06.2014, për punonjësen *****;
 - ✓ Aktin e deklaramit nr. 129, datë 03.06.2014, për punonjësin *****;
 - ✓ Aktin e deklaramit nr. 130, datë 30.06.2014, për punonjësen *****;
 - Aktin e deklaramit nr. 128, datë 03.06.2014, për punonjësin *****.

Marrëdhënia e punës për këta punonjës të vazhdojë sipas parashikimeve ligjore në fuqi.

5. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, për rregullimin e gjendjes së paligjshmërisë, për punonjësit e emëruar në pozicione të shërbimit civil dhe që nuk përmbushin kriterin e nivelit arsimor, pasi janë me arsim të mesëm, pavarësisht faktit se aktualisht kanë kaluar në pozicione pune jashtë shërbimit civil, duhet të bëjë refuzimin e deklaramit të statusit të nëpunësit civil dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësit e mëposhtëm:
 1. ***** emëruar me aktin nr. 76, datë 23.11.2005, në pozicionin “Specialist Teknik Ndërtimi”;

2. ***** , emëruar me aktin nr. 18, datë 16.05.2006, në pozicionin “Administrator i Invalidëve të Punës”
 3. ***** , emëruar me aktin nr. 60, datë 24.09.2001, në pozicionin “Administrator i PAK”;
 4. ***** , emëruar me aktin nr. 12, datë 01.04.2011, në pozicionin “Administratore e Ndihmës Ekonomike Rajoni nr.4”;
 5. ***** , emëruar me aktin nr. 35, datë 01.02.2012, në pozicionin “Specialiste e Arkivës”;
 6. ***** , emëruar me aktin nr. 51, datë 06.05.2010, në pozicionin “Përgjegjëse e Sektorit Njësia Administrative nr.1”;
 7. ***** , emëruar me aktin nr. 76, datë 09.04.2002, në pozicionin “Specialist Inspektor në Njësinë Administrative nr.1”;
 8. ***** , emëruar me aktin nr. 23, datë 01.04.2008, në pozicionin “Specialist Inspektor në Njësinë Administrative nr.1”.
 9. ***** , emëruar me aktin nr. 71, datë 13.08.2012, në pozicionin “Specialist Inspektor në Njësinë Administrative nr.2”.
 10. ***** , emëruar me aktin nr. 47, datë 26.09.2003, në pozicionin “Specialist Inspektor në Njësinë Administrative nr.3”.
 11. ***** , emëruar (në dosjen e personelit mungonte akti i emërimit) në pozicionin “Specialist Inspektor në Njësinë Administrative nr.3”.
 12. ***** , emëruar me aktin nr. 10, datë 04.01.2012, në pozicionin “Specialist Inspektor në Njësinë Administrative nr.3”.
6. Për punonjësin ***** , të cilin momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori Njësia Administrative nr.2”, pozicion pune pjesë e shërbimit civil, njësia përgjegjëse duhet të kryejë të gjitha veprimet administrative që kanë lidhje me verifikimin e statusit të punësimit dhe në përfundim të nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit për këtë punonjës.
7. Njësia përgjegjëse pranë Bashkisë Shkodër, të refuzojë statusin e nëpunësit civil dhe të përfundojë marrëdhënien e punës, duke evidentuar faktin e mospërbushjes së kriterit të nivelit arsimor për të qenë nëpunës civil, sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për punonjësit të cilët janë me arsim të mesëm, ose që nuk i plotësojnë kriteret arsimore, në lidhje me nivelin e arsimit të lartë, si më poshtë:
- Në Njësinë Administrative Velipojë:
 - ✓ ***** , emëruar me aktin nr. 280, datë 30.10.2011, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Grumbullimit”;
 - ✓ ***** , emëruar me aktin nr. 13, datë 01.03.2011, në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Turizmit dhe Mjedisit”, (me diplomë në nivelin bachelor);
 - ✓ ***** , emëruar me aktin nr. 160, datë 16.09.2011, në pozicionin “Inspektor Veterinar dhe i Mbrojtjes së Konsumatorit”;
 - ✓ ***** , emëruar me aktin nr. 151, datë 16.09.2011, në pozicionin “Inspektor i Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve”;

- ✓ ***** , emëruar me aktin nr. 23, datë 29.02.2012, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Përkrahjes Sociale” (vërtetim se është duke ndjekur universitetin);
- ✓ ***** , emëruar me aktin nr. 40, datë 31.07.2013, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit”;
- ✓ ***** , emëruar me aktin nr. 47, datë 31.08.2013, në pozicionin “Inspektor i Arsimit, Kulturës dhe Sporteve”;
- ✓ ***** , emëruar me aktin nr. 63, datë 31.10.2013, në pozicionin “Specialist Informatike Mirëmbajtje WEB”.

- Në Njësinë Administrative Rrethina:

- ✓ ***** , emëruar me aktin nr. 33, datë 13.06.2013, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Sociale”;

- Në Njësinë Administrative Shalë:

- ***** , në pozicionin “Arkëtar Arkivist”;
- ***** , në pozicionin “Administrator i Paaftësisë”.

- Në Njësinë Administrative Ana e Malit:

- ✓ ***** , i cili mban pozicionin e “Inspektorit të Marrëdhënieve me Publikun dhe Arkiva”.

- Në Njësinë Administrative Guri i Zi:

- ✓ ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së të Ardhurave”;

- Në Njësinë Administrative Postribë:

- ✓ ***** , emëruar në pozicionin “Specialist i Protokoll Arkivës”;

Pozicionet e punës të mbajtura nga këta punonjës, duhet të konsiderohen pozicione të lira, për t'u plotësuar më tej në përputhje me ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Shkodër.

8. *Njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, pasi të plotësojë dosjet e personelit me aktet e konstatuara si në mungesë në përmbajtjen e Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes, të verifikojë plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme për të qenë nëpunës civil. Në varësi të rezultateve të verifikimit, të vendosë sipas rastit deklarinimin si “nëpunës civil” ose “nëpunës civil në periudhë prove” (duke u kujdesur për përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ligji dhe aktet nënligjore në lidhje me periudhën e provës) ose përfundimin e marrëdhënies së punësimit në shërbimin civil, duke evidentuar faktin e mospërmbushjes së kriterëve ligjore specifike, për punonjësit e mëposhtëm:*

- Në Njësinë Administrative Velipojë:

- ***** , emëruar me aktin nr. 9, datë 03.01.2012, në pozicionin “Inspektor Buxheti”;
- ***** , emëruar me aktin nr. 16, datë 01.03.2011, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane”;
- ***** , emëruar me aktin nr. 154, datë 16.09.2011, në pozicionin “Drejtor i Planifikim Territorit”;
- ***** , emëruar me aktin nr. 155, datë 16.09.2011, në pozicionin “Inspektor i Menaxhimit dhe Administrimit të Tokës”.
- ***** , emëruar me aktin nr. 3, datë 30.01.2014, në pozicionin “Jurist”;
- ***** , emëruar me aktin nr. 5, datë 31.03.2013, në pozicionin “Drejtor i të Ardhurave”;
- ***** , emëruar me aktin nr. 47, datë 31.08.2013, në pozicionin “Inspektor për Detyrimet Fiskale”.

- Në Njësinë Administrative Ana e Malit:

- ***** , në pozicionin “Inspektor Finance”

- Në Njësinë Administrative Guri i Zi:

- ***** , në pozicionin “Specialist i Sektorit të Financë Buxhetit”;
- ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Përkrahjes Sociale”.

- Në Njësinë Administrative Bërdicë:

- ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Bujqësisë, Blegtorisë, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Pronave”;
- ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, Infrastrukturës Publike dhe Investimeve”.
- ***** , në pozicionin e punës “Inspektor Taksash”;
- ***** , në pozicionin e punës “Inspektor Taksash”;
- ***** , në pozicionin e punës “Inspektor Bujqësie”.

- Në Njësinë Administrative Shosh:

- ***** , i cili mbante pozicionin e “Përgjegjësit të Financës” (sipas librezës së punës është emëruar në datë 02.06.1999).

9. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër për rregullimin e paligjshmërisë në rastet e punonjësve të cilët nuk kanë përmbushur kushtin e detyrueshëm ligjor për të kryer ciklin e trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), (i cili është një nga elementët e domosdoshëm ligjorë, për të përmbyllur pozitivisht procesin e konfirmimit si nëpunës civil), të anulojë aktet e konfirmimit si nëpunës civil të punonjësve të poshtëshënuar dhe në zbatim të përcaktimeve të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për

pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, të shtyhet periudha e provës për këta nëpunës dhe vlerësimi për konfirmimin e tyre, të bëhet pasi të përfundohet me sukses trajnimi i detyrueshëm në Shkollën e Administratës Publike (ASPA).

- Në Njësinë Administrative Rrethina:

- Aktin e konfirmimit nr. 3, datë 20.04.2015, për punonjës in *****;
- Aktin e konfirmimit nr. 8, datë 20.04.2015, për punonjës in *****;
- Aktin e konfirmimit nr. 5, datë 20.04.2015, për punonjës in *****;
- Aktin e konfirmimit nr. 15, datë 20.04.2015, për punonjës in *****;
- Aktin e konfirmimit nr. 10, datë 20.04.2015, për punonjës in *****.

10. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, të anulojë aktet e emërimit dhe aktet e deklaramit të statusit të punësimit, që kanë dalë në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pa kryer më parë procedurën e konkurrimit, të kërkuar nga nenet 22, e vijues të këtij ligji, si dhe të ndërpresë marrëdhënien e punës, për punonjësit e përmendur më poshtë, të ndarë sipas njësive administrative:

- Në Njësinë Administrative Velipojë:

- ✓ Aktin e emërimit nr. 1, datë 08.04.2015, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës Juridike” dhe aktin e deklaramit si nëpunës civil nr. 470, datë 28.04.2015, për punonjës in *****;
- ✓ Aktin e emërimit nr. 1, datë 08.04.2015, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit” dhe aktin e deklaramit si nëpunës civil nr. 472, datë 28.04.2015 për punonjës in *****;
- ✓ Aktin e emërimit nr. 16, datë 30.07.2015, në pozicionin “Inspektor i Planifikimit”, për punonjës in *****;
- ✓ Aktin e emërimit nr. 1, datë 08.04.2015, në pozicionin “Drejtor Finance”, dhe aktin e deklaramit si nëpunës civil nr. 471, datë 28.04.2015, për punonjës in *****;
- ✓ Aktin e emërimit nr. 1, datë 08.04.2015, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Financës”, për punonjës in *****;
- ✓ Aktin e emërimit nr. 13, datë 15.04.2015, në pozicionin “Inspektor i Financës”, për punonjës in *****;
- ✓ Aktin e emërimit nr. 7, datë 28.02.2014, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Planifikim Territorit dhe Kadastrës Urbane”, për punonjës in *****;
- ✓ Aktin e emërimit nr. 7, datë 28.02.2014, në pozicionin “Drejtor i Marrëdhënieve me Publikun”, për punonjës in *****.

- Në Njësinë Administrative Rrethina:

- Aktin e emërimit nr. 13, datë 10.03.2014, në pozicionin “Inspektor i Sektorit të të Ardhurave” dhe aktin e deklaramit si nëpunës civil nr. 01, datë 20.04.2014, për punonjës in *****.

- Në Njësinë Administrative Postrribë:
 - Aktin e emërimit në pozicionin “Jurist” dhe aktin e deklarimit si nëpunës civil nr. 3, datë 30.04.2015, për punonjës *****.

Pozicionet e punës të zëna nga këta punonjës, duhet të konsiderohen pozicione të lira, për t`u plotësuar më tej, në përputhje me ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në koherencë me strukturën aktuale të Bashkisë Shkodër.

11. Pozicionet e mëposhtme të shpallen të lira dhe të plotësohen nëpërmjet procedurës së konkurrimit, sipas kërkesave të neneve 22, 23, 24, e vijues të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar në përputhje me dinamikën dhe nevojat sipas strukturës aktuale të Bashkisë Shkodër:

- Për Bashkinë Shkodër:
 - ✓ Inspektor Biznesi i Madh;
 - ✓ Drejtor Drejtorie i Shërbimeve Sociale, Arsimit, Kulturës, Sporteve dhe Gruas;
 - ✓ Specialist Finance;
 - ✓ Specialist Buxheti.
- Për Njësinë Administrative Velipojë:
 - Drejtor i Turizmit dhe Mjedisit;
 - Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës;
 - Përgjegjës i Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun.
- Për Njësinë Administrative Rrethina:
 - ✓ Inspektor i Urbanistikës.
- Për Njësinë Administrative Daçë:
 - ✓ Përgjegjës për Menaxhimin dhe Mbrojtjen e Tokës.
- Për Njësinë Administrative Bërdicë:
 - ✓ Përgjegjës i Zyrës Juridike dhe Protokoll Arkivës.

12. Njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër të zbatojë detyrat si më poshtë:

- ✓ Të anulojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr. 06, datë 20.04.2015, në pozicionin e “Përgjegjësit të Sektorit”, për punonjës *****, në kushtet kur fillimi i efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e ka gjetur në pozicionin e “Specialistit për Taksat dhe Tarifat Vendore” pranë Komunës Rrethina, dhe ngritja në detyrë është bërë pa respektuar procedurat ligjore. Pasi të

vlerësojë periudhën e punësimit të tij në pozicionin e “Specialistit për Taksat dhe Tarifat Vendore” (duke qenë se në dosje mungonte akti i emërimit), të bëjë deklarinë e statusit të punësimit si “nëpunës civil” apo “nëpunës civil në periudhë prove” në këtë pozicion pune.

- ✓ *Të anulojë aktin nr. 01, datë 20.04.2015, për deklarinë si nëpunës civil në pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë, pranë Komunës Rrethina, të nëpunësit *****, në kushtet kur ky punonjës nuk ka punuar për asnjë moment në këtë pozicion.*
- ✓ *Të anulojë aktin e deklarinë të statusit të punësimit për nëpunësen *****, emëruar në datë 31.01.2014, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës Juridike” pranë Komunës Guri i Zi, duke nxjerrë aktin e deklarinë të statusit të punësimit si “nëpunës civil në periudhë prove”, duke qenë se ka pasur më pak se një vit në atë pozicion pune. Njësia përgjegjëse të kujdeset që të respektohen kërkesat ligjore, duke përfshirë detyrimet që rrjedhin nga neni 24, i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

13. *Të plotësohen dosjet e personelit, sipas konstatimeve të evidentuara në aneksin nr. 1, Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit për nëpunësit që punonin në pozicione të shërbimit civil, në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (data 26.02.2014) dhe aneksin nr. 2, “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në datën 26.02.2014, si dhe të punonjësve që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil”, të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.*

14. *Njësia përgjegjëse të rregullojë ligjshmërinë e veprimeve të kryera gjatë procesit të implementimit të strukturës së re në institucion, pas procesit të ristrukturimit duke ndjekur orientimet e mëposhtme.*

Për arsye se nga ana e njësisë përgjegjëse të ish Komunave, nuk është kryer procesi i deklarinë të statusit të punësimit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, duhet të përfundojë procesin e deklarinë të statusit të punësimit për të gjithë punonjësit e prekur nga procesi i ristrukturimit.

Për punonjësit që nuk i përmbushin kërkesat për të qenë nëpunës civil, të refuzohet deklarimi i statusit të nëpunësit civil dhe të ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak të ligjit dhe jo për arsye ristrukturimi.

Nisur nga fakti i mosrespektimit të procedurave ligjore në një rast ristrukturimi në këtë subjekt për rregullimin ligjor, institucioni duhet të revokojë të gjitha aktet administrative që kanë dalë deri në këtë moment në lidhje me këtë proces, në kundërshtim me ligjin, dhe të fillojë procesin nga e para, duke ndjekur këtë rend pune:

a) Ngritja e Komisionit të Ristrukturimit, duke u kujdesur që të respektohen kërkesat ligjore në përbërjen e tij, i cili, bazuar në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ka të drejtë të propozojë sistemimin dhe trajtimin financiar për të gjithë nëpunësit të cilët do të largohen për shkak të ristrukturimit, duke krahasuar përshkrimin e punës, kërkesat specifike, si dhe çdo kërkesë tjetër që rrjedh nga dispozitat ligjore dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë rast, për çdo pozicion që nuk ekziston më. Në këtë rast duhet të jetë në vëmendjen e njësisë përgjegjëse, Udhëzimi nr.3, datë 14.04.2014, i Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, ku përcaktohen qartë rregullat e përgjithshme për krijimin dhe funksionimin e këtij mekanizmi.

b) Komisioni i Ristrukturimit, të paraqesë propozimet për lirim nga shërbimi civil, të atyre nëpunësve, pozicioni i të cilëve nuk ekziston më, apo është riorganizuar, kompetencë e tij që është e parashikuar në pikën 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe në Vendimin nr.124, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil” dhe në Vendimin nr.125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë”.

c) Përmbyllja e procesit me vendimin përfundimtar për lirim nga shërbimi civil, apo riemërimin në pozicione të së njëjtës kategori, sipas dispozitave të mësipërme, duhet të merret nga njësia përgjegjëse, pasi të analizojë propozimet e Komisionit të Ristrukturimit.

Në këtë rast, akti i emërimit duhet të jetë nominal për çdo punonjës, ku të përcaktohet pozicioni i punës dhe kategoria e pagës.

Duhet të tregohet kujdes, që në rastet e uljes në detyrë të punonjësit, duhet të merret mendimi i tij me shkrim për pranimin, ose refuzimin e pozicionit të ofruar, siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”.

d) Hartimi i përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, sipas parashikimeve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, që përbën një proces kompleks dhe që është kusht, pa të cilin nuk mund të kryhet risistemimi i punonjësve në të njëjtin pozicion, transferimi i tyre, apo regjistrimi i tyre në listën e pritjes.

Kjo për faktin se puna e Komisionit të Ristrukturimit është e lidhur me krahasimin e kërkesave specifike për pozicionin e punës, çka është një rubrikë e rëndësishme e që përfshihet në formularin e përshkrimit të punës.

Kujdes i veçantë të tregohet sidomos për respektimin e të gjitha të drejtave që parashikon pika 7, e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për punonjësit të cilët lirohen nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit, ndër të cilat e drejta e dëmshpërblimit në përputhje me vjetërsinë në punë, e drejta për të konkurruar për një periudhë 2-vjeçare në procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në

detyrë, si dhe e drejta për t'u emëruar në mënyrë të përkohshme nga njësi përgjegjëse, me pëlqimin e tyre, në pozicione pune që janë pjesë e shërbimit civil.

15. *Në lidhje me informacionet e ardhura në drejtim të Komisionerit të cilat janë trajtuar gjatë mbikëqyrjes, njësi përgjegjëse e Bashkisë Shkodër duhet të veprojë si më poshtë:*

- *Të anulojë aktin nr. 1171/b, datë 01.10.2015, "Akt revokimi të statusit të nëpunësit civil" dhe aktin nr. 474, datë 28.04.2015, për konfirmimin si nëpunës civil në pozicionin "Përgjegjës i Zyrës së Zhvillimit" të njësisë përgjegjëse të Komunës Velipojë, për nëpunësin *****, duke saktësuar si pozicion pune pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Publike", në të cilin e gjeti fillimi i efekteve juridike të ligjit për nëpunësin civil.*

Pas kësaj, njësi përgjegjëse, duhet të trajtojë këtë punonjës, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, i cili rregullon institutin e ristrukturimit, duke e emëruar në një pozicion të shërbimit civil, ku ai i plotëson kërkesat e vendit të punës, dhe në pamundësi për ta sistemuar, t'i njohë atij gjithë të drejtat që përfiton nga kjo dispozitë e ligjit, të cilat janë analizuar me hollësi më lart.

Procedura e ristrukturimit, edhe në këtë rast, duhet të realizohet sipas orientimeve që janë dhënë në pikën 14 të këtij vendimi.

16. *Të hartohen përshkrimet e reja të punës për të gjitha pozicionet që janë pjesë e shërbimit civil, sipas formatit standard të miratuar, ashtu si përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" dhe lidhjes 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil". Në përfundim të këtij procesi, njësi përgjegjëse të analizojë nëse punonjësit aktualë në pozicione pune të shërbimit civil, i plotësojnë ose jo kërkesat e vendit të punës.*

17. *Të hartohet menjëherë plani vjetor i nevojave për rekrutimin në shërbimin civil, mbi bazën e kërkesave të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil" dhe në të ardhmen të respektohet afati ligjor në lidhje me këtë proces.*

18. *Njësi përgjegjëse të drejtojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve për vitin 2016, duke hartuar formularët e vlerësimit të punës, sipas formatit të miratuar dhe në mbështetje të kërkesave ligjore të përcaktuara, në nenin 62, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë", si dhe të orientojë aktorët që marrin pjesë në këtë proces për të zbatuar drejt procedurat ligjore. Formulari i plotësuar dhe i nënshkruar, prej nëpunësve të ngarkuar nga ligji duhet të administrohet në dosjen e personelit për punonjësit e vlerësuar.*

19. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijani për këtë vendim. Njësia përgjegjëse, duhet të zbatojë këtë vendim duke u bazuar në detyrat dhe orientimet e materializuara në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin nr. 177, datë 30.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Shkodër”, të Komisionerit, me vendimin nr.117, datë 05.05.2017, “Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 177, datë 30.12.2016,”Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe paralajmërimit të institucionit për të rregulluar ligjshmërinë gjatë administrimit të shërbimit civil, në Bashkinë Shkodër”, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të këtij vendimi.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Ilirjan Osmanlliu dhe Joni Marko, Specialistë në Drejtorinë e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të cilët në datën 22.05.2017, u paraqitën pranë institucionit Bashkia Shkodër.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe verifikoi materialet shkresore të cilat vërtetohnin zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në vendimin paralajmërues.

Pasi u administruan dhe u trajtuan materialet shkresore, të vëna në dispozicion, rezultoi se:

- Në zbatim të pikës 2 të vendimit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër ka anuluar aktin administrativ nr.106, datë 30.06.2014, me anë të cilit punonjësja ***** është konfirmuar “Nëpunëse civile” në pozicionin e punës “Përgjegjëse e Sektorit Juridik” dhe ka nxjerrë aktin nr.98, datë 20.03.2017, “Nëpunës civil në periudhë prove”, për këtë punonjëse në pozicionin e mësipërm.
- Në lidhje me rekomandimin e bërë në pikën 3 vendimit, për anulimin e akteve administrative të konfirmimit si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës, njësia përgjegjëse, ka vepruar si më poshtë:
 - Ka anuluar aktin administrativ nr.111, datë 30.03.2014, me anë të të cilit punonjësja ***** është konfirmuar “Nëpunëse civile” në pozicionin e punës “Juriste në Drejtorinë Juridike” dhe ka nxjerrë aktin nr.91, datë 20.03.2017, “Nëpunës civil në periudhë prove”, për këtë punonjëse në pozicionin e mësipërm;
 - Ka anuluar aktin administrativ nr.132, datë 30.06.2014, me anë të të cilit punonjësja ***** është konfirmuar “Nëpunëse civile” në pozicionin e punës “Specialiste Strehimi” dhe ka nxjerrë aktin nr.92, datë 20.03.2017, “Nëpunës civil në periudhë prove”, për këtë punonjëse në pozicionin e mësipërm;
 - Ka anuluar aktin administrativ nr.127, datë 30.06.2014, me anë të të cilit punonjësi ***** është konfirmuar “Nëpunës civil” në pozicionin e punës “Specialist i Infrastrukturës Nëntoksore” dhe ka nxjerrë aktin nr.93, datë 20.03.2017, “Nëpunës civil në periudhë prove”, për këtë punonjës në pozicionin e mësipërm.

Më tej, bazuar në nenin 24 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe në zbatim të rekomandimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse, me shkresën nr.5293, datë 20.04.2017, drejtuar Shkollës së Administratës Publike, ka dërguar listën e nëpunësve civilë të Bashkisë Shkodër për trajnim të detyrueshëm, përfshi edhe punonjësit e mësipërm.

➤ Njësia përgjegjëse në zbatim të rekomandimit të pikës 4 të vendimit të Komisionerit, ka anuluar aktet e deklaramit të statusit të punësimit të punonjësve, për shkak se pozicioni i tyre i punës nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, si më poshtë vijon:

- Me aktin administrativ nr.95, datë 20.03.2017, është bërë anulimi i deklaramit të statusit të punësimit nr.129, datë 03.06.2014, për punonjës in ***** me detyrë “Supervizor i Shërbimeve të Gjellbërimit dhe Pastrimit të Varrezave Publike”;
- Me aktin administrativ nr.93, datë 20.03.2017, është bërë anulimi i deklaramit të statusit të punësimit nr.130, datë 03.06.2014, për punonjës in ***** me detyrë “Supervizor i Shërbimeve të Gjellbërimit dhe Pastrimit të Varrezave Publike”;
- Me aktin administrativ nr.94, datë 20.03.2017, është bërë anulimi i deklaramit të statusit të punësimit nr.128, datë 03.06.2014, për punonjës in ***** me detyrë “Supervizor i Shërbimeve të Gjellbërimit dhe Pastrimit të Varrezave Publike”;
- Me aktin administrativ nr.98, datë 20.03.2017, është bërë anulimi i deklaramit të statusit të punësimit nr.115, datë 03.06.2014, për punonjës in ***** me detyrë “llogaritare-Arkëtare”.

➤ Në zbatim të pikës 5 të Vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse ka vendosur përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësit që mbanin pozicione të shërbimit civil, për shkak të mospërmbushjes së kriterit arsimor, si më poshtë:

1. *****, liruar nga detyra “Specialist Teknik Ndërtimi” dhe me aktin nr. 287, datë 30.10.2015, është emëruar në detyrën “Teknik Ndërtimi”, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
2. *****, liruar nga detyra “Administrator i Invalidëve të Punës” dhe me aktin nr. 261/8, datë 11.05.2016 është emëruar në detyrën “Ndihmës Specialiste”, në Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
3. *****, liruar nga detyra “Administrator i PAK” dhe me aktin nr. 261/9, datë 11.05.2016 është emëruar në detyrën “Ndihmës Specialiste”, në Njësinë e Administrimit të Ndihmës Ekonomike në Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
4. *****, liruar nga detyra “Administratore e Ndihmës Ekonomike Rajoni nr.4” dhe me aktin nr. 261/7, datë 11.05.2016 është emëruar në detyrën “Ndihmës Specialiste”, në Njësinë e Administrimit të Ndihmës Ekonomike në Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike, pozicion pune jashtë shërbimit civil;

5. *****, liruar nga detyra “*Specialiste e Arkivës*” dhe me aktin nr. 286, datë 30.10.2015 është emëruar në detyrën “*Arkiviste*”, në Drejtorinë e Studimeve, Planifikimit, Koordinimit dhe Monitorimit të Investimeve, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
 6. *****, liruar nga detyra “*Përgjegjëse e Sektorit Njësia Administrative nr.1*” dhe me aktin nr. 261/36, datë 11.05.2016 është emëruar në detyrën “*Ndihmës Inspektor Rajoni*”, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
 7. *****, liruar nga detyra “*Specialist Inspektor në Njësinë Administrative nr.1*” dhe me aktin nr. 261/35, datë 11.05.2016 është emëruar në detyrën “*Ndihmës Inspektor Rajoni*”, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
 8. *****, liruar nga detyra “*Specialist Inspektor në Njësinë Administrative nr.1*” dhe me aktin nr. 261/37, datë 11.05.2016 është emëruar në detyrën “*Ndihmës Inspektor Rajon Nr.1i*”, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
 9. *****, liruar nga detyra “*Specialist Inspektor në Njësinë Administrative nr.2*” dhe me aktin nr. 261/33, datë 11.05.2016 është emëruar në detyrën “*Ndihmës Inspektor Rajoni Nr.2*”, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
 10. *****, liruar nga detyra “*Specialist Inspektor në Njësinë Administrative nr.3*” dhe me aktin nr. 261/40, datë 11.05.2016 është emëruar në detyrën “*Ndihmës Inspektor Rajoni Nr.3*”, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
 11. *****, liruar nga detyra “*Specialist Inspektor në Njësinë Administrative nr.3*” dhe me aktin nr. 261/38, datë 11.05.2016 është emëruar në detyrën “*Ndihmës Inspektor Rajoni Nr.5*”, pozicion pune jashtë shërbimit civil;
 12. *****, liruar nga detyra “*Specialist Inspektor në Njësinë Administrative nr.3*” dhe me aktin nr. 261/34, datë 11.05.2016, është emëruar në detyrën “*Ndihmës Inspektor Rajoni Nr.4*”, pozicion pune jashtë shërbimit civil.
- Në zbatim të pikës 6 të vendimit të Komisionerit, rezulton se njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, për punonjësën Gëzim Kraja, të cilin hyrja në fuqi e ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, e gjeti në pozicion pune pjesë e shërbimit civil, pasi ka verifikuar nëse plotësonte kriteret e përcaktuara në nenin 21 të këtij ligji, bazuar në nenin 67, pika 3 të tij, me aktin administrativ nr. 1191/6, datë 01.10.2015, ka deklaruar statusin e punësimit si “*nëpunës civil*”, në pozicionin “*Përgjegjës Sektori Njësia Administrative nr. 2*”.
- Në zbatim të pikës 7 vendimit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër ka vepruar në këtë mënyrë:

Në Njësinë Administrative Velipojë

Nga ana e Komisionerit është kërkuar refuzimi i statusit të nëpunësit civil, për punonjësit që nuk plotësojnë kriterin arsimor sipas përcaktimeve të nenit 21 të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.116, datë 05.03.2014, “*Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të Këshillit të Ministrave, si më poshtë:*

- ***** , emëruar me aktin nr. 280, datë 30.10.2011, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Grumbullimit”;
- ***** , emëruar me aktin nr. 13, datë 01.03.2011, në pozicionin “Përgjegjës në Sektorin e Turizmit dhe Mjedisit”, (me diplomë në nivelin bachelor);
- ***** , emëruar me aktin nr. 160, datë 16.09.2011, në pozicionin “Inspektor Veterinar dhe i Mbrojtjes së Konsumatorit”;
- ***** , emëruar me aktin nr. 151, datë 16.09.2011, në pozicionin “Inspektor i Menaxhamit dhe Administrimit të Pyjeve”;
- ***** , emëruar me aktin nr. 23, datë 29.02.2012, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Përkrahjes Sociale” (vërtetim se është duke ndjekur universitetin);
- ***** , emëruar me aktin nr. 40, datë 31.07.2013, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit”;
- ***** , emëruar me aktin nr. 47, datë 31.08.2013, në pozicionin “Inspektor i Arsimit, Kulturës dhe Sporteve”;
- ***** , emëruar me aktin nr. 63, datë 31.10.2013, në pozicionin “Specialist Informatike Mirëmbajtje WEB”.

Njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër nuk ka vepruar në lidhje me rekomandimin e pikës 6 të vendimit të Komisionerit, për arsye se këto punonjës kanë ndërprerë marrëdhënien e punësimit me Njësinë Administrative Velipojë, përpara hyrjes në fuqi të Vendimit nr.93, datë 01.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Shkodër, institucioneve të varësisë dhe shërbimeve publike” dhe përpara konstituimit të organit të qeverisjes vendore, Bashkia Shkodër sipas përcaktimeve të ligjit nr.115/2014, “Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, që e përcakton këtë të fundit si trashëgimtarin ligjor të njësive të qeverisjes vendore që janë shkrire në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ.

Në Njësinë Administrative Rrethina

Njësia Përgjegjëse në zbatim të vendimit të Komisionerit, me aktin administrativ nr.1191/6, datë 01.10.2015, ka anuluar deklarimin e statusit të punësimit nr. 7, datë 20.04.2015, për punonjësen ***** , në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve Sociale” dhe ka përfunduar marrëdhënien e punësimit me këtë punonjëse.

Në Njësinë Administrative Shalë

Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Shkodër, nuk ka vepruar në lidhje me marrëdhënien e punësimit të punonjësit ***** , në pozicionin “Arkëtar Arkivist” sipas rekomandimit të vendimit të Komisionerit, për arsye se ky punonjës ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit me Njësinë Administrative Shalë, përpara hyrjes në fuqi të Vendimit nr.93, datë 01.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, “Për miratimin e

strukturës organizative të administratës së Bashkisë Shkodër, institucioneve të varësisë dhe shërbimeve publike”.(nuk figuron në strukturën e cituar më sipër)

Në rastin e punonjësit *****, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.239, datë 30.10.2015, ka emëruar punonjës, në pozicionin “*punonjës mbështetës në shërbime publike*”, pranë Bashkisë Shkodër, pozicion pune që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Pavarësisht zbatimit jo korrekt të rekomandimit të Komisionerit në këtë rast, duke qenë se punonjësi në fjalë tashmë është larguar nga shërbimi civil, kjo detyrë e lënë njësive përgjegjëse do të konsiderohet e zbatuar, duke i tërhequr vëmendjen kësaj të fundit që në të ardhmen të zbatohet me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.

Në Njësine Administrative Ana e Malit

Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Shkodër, nuk ka vepruar në lidhje me marrëdhënien e punësimit të punonjësit *****, në pozicionin “*Inspektor i Marrëdhënieve me Publikun dhe Arkivat*” sipas rekomandimit të Komisionerit, për arsye se ky punonjës ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit me Njësine Administrative Ana e Malit, përpara hyrjes në fuqi të Vendimit nr.93, datë 01.10.2015 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, “*Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Shkodër, institucioneve të varësisë dhe shërbimeve publike*” (nuk figuron në këtë strukturë) dhe përpara konstituimit të organit të qeverisjes vendore, Bashkia Shkodër sipas përcaktimeve të ligjit nr.115/2014, “*Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë*”, që e përcakton këtë të fundit si trashëgimtarin ligjor të njësive të qeverisjes vendore që janë shkruar në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ.

Në Njësine Administrative Gur i Zi

Në rastin e punonjësit *****, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.244, datë 30.10.2015, ka emëruar punonjës, në pozicionin “*punonjës mbështetës në shërbime publike*”, pranë Bashkisë Shkodër, pozicion pune që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Pavarësisht zbatimit jo korrekt të rekomandimit të Komisionerit në këtë rast, duke qenë se punonjësi në fjalë tashmë është larguar nga shërbimi civil, kjo detyrë e lënë njësive përgjegjëse do të konsiderohet e zbatuar, duke i tërhequr vëmendjen kësaj të fundit që në të ardhmen të zbatohet me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.

Në Njësine Administrative Postribë

Në rastin e punonjësit *****, njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.605/6, datë 01.09.2016, ka emëruar punonjës, në pozicionin “*punonjës sekretarie*”, pranë Bashkisë Shkodër, pozicion pune që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Pavarësisht zbatimit jo korrekt të rekomandimit të Komisionerit në këtë

rast, duke qenë se punonjësi në fjalë tashmë është larguar nga shërbimi civil, kjo detyrë e lënë në njësishë përgjegjëse do të konsiderohet e zbatuar, duke i tërhequr vëmendjen kësaj të fundit që në të ardhmen të zbatohet me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.

Në përputhje me vendimin e Komisionerit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, Me shkresën nr. 664/b prot., date 28.02.2017, “*Plani vjetor i pranimeve në shërbimin civil për vitin 2017*”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, i ka shpallur të lira pozicionet e mësipërme (aktet e shpalljes janë administruar nga grupi i punës dhe janë bërë pjesë e dosjes së verifikimit të zbatimit të vendimit).

- Në lidhje me rekomandimin e Komisionerit në pikën 8 të vendimit, Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, ka plotësuar dosjet e personelit me dokumentacionin e konstatuar të munguar (dëshmi penalteti dhe raporte mjekësore) dhe pasi ka verifikuar kriteret e përgjithshme e të posaçme të punonjësve, ka vepruar si më poshtë:

Në Njësishë Administrative Velipojë

Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Shkodër, nuk ka vepruar në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit të ish-punonjësve të Komunës Velipojë për shkak të mosplotësimit të kriterit arsimor (*për punonjësit ******, *****), për arsye se këta punonjës kanë ndërprerë marrëdhënien e punësimit me Njësishë Administrative Velipojë, përpara hyrjes në fuqi të Vendimit nr.93, datë 01.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, “*Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Shkodër, institucioneve të varësisë dhe shërbimeve publike*”. Në strukturën organizative të ish-Komunës Velipojë, të miratuar me Vendimi n nr.7, datë 20.03.2015 “*Për miratimin e strukturës së administratës dhe shërbimeve dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve*”, punonjësit e përmendur më poshtë, nuk janë në strukturë, çka provon se marrëdhënia e tyre e punësimit është ndërprerë përpara konstituimit të organit të qeverisjes vendore, Bashkia Shkodër sipas përcaktimeve të ligjit nr.115/2014, “*Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë*”, që e përcakton këtë të fundit si trashëgimtarin ligjor të njësive të qeverisjes vendore që janë shkrirë në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ.

Në Njësishë Administrative Ana e Malit

Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Shkodër, nuk ka vepruar në lidhje me marrëdhënien e punësimit të punonjësit *****, në pozicionin “*Inspektor finance*”, sipas rekomandimit të vendimit të Komisionerit, për arsye se ky punonjës ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit me Njësishë Administrative Ana e Malit, përpara hyrjes në fuqi të Vendimit nr.93, datë 01.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, “*Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Shkodër, institucioneve të varësisë dhe shërbimeve publike*” (nuk figuron në këtë strukturë) dhe përpara konstituimit të

organit të qeverisjes vendore, Bashkia Shkodër sipas përcaktimeve të ligjit nr.115/2014, “Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, që e përcakton këtë të fundit si trashëgimtarin ligjor të njërive të qeverisjes vendore që janë shkrië në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ (*Për më tepër, sipas strukturës së miratuar me anë të Vendimit të Këshillit të Komunës nr.5, datë 16.02.2015, “Për miratimin e strukturës organizative për vitin 2015”, punonjësi Hydajet Ylli ushtron detyrën “Punonjës i shërbimeve të pastrimit”, pozicion pune që nuk përfshihet në shërbimin civil).*

Në Njësinë Administrative Guri i Zi

Njësia Përgjegjëse në zbatim të vendimit të Komisionerit, me aktin administrativ nr.539, datë 01.08.2016, ka liruar nga detyra “specialiste e ndihmës ekonomike”, pranë Bashkisë Shkodër, punonjësen *****. Nga përmbajtja e aktit nr.9404, datë 27.07.2016, “Njoftim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, shkaku i ndërprerjes është mosplotësimi i kriterit arsimor.

Njësia Përgjegjëse, me aktin administrativ nr.88, datë 28.09.2015, ka liruar nga detyra “Përgjegjës i Zyrës së Përkrahjes Sociale”, pranë Bashkisë Shkodër, punonjësin *****. Shkaku i lirimit të tij nga detyra është kërkesa me shkrim për dorëheqje nr.6523, datë 22.09.2015.

Në Njësinë Administrative Bërdicë

Njësia Përgjegjëse, pasi ka verifikuar plotësimin e kriterëve ligjore për të qenë nëpunës civil të punonjësve ***** dhe *****, bazuar në nenin 67 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe në zbatim të rekomandimit të Komisionerit ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit nr.1189/3, datë 01.10.2015, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Bujqësisë”, për punonjësin ***** dhe aktin e deklaramit të statusit të punësimit nr.1188/3, datë 01.10.2015, në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës”, për punonjësin *****.

Përsa i përket punonjësve: ***** me detyrë “Inpektor Taksash”; ***** me detyrë “Inspektor Taksash” dhe ***** me detyrë “Inspektor Bujqësie”, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Shkodër, nuk ka vepruar në lidhje me marrëdhënien e punësimit të tyre, sipas rekomandimit të vendimit të Komisionerit, për arsye se punonjësit në fjalë kanë ndërprerë marrëdhënien e punësimit me Njësinë Administrative Bërdicë, përpara hyrjes në fuqi të Vendimit nr.93, datë 01.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Shkodër, institucioneve të varësisë dhe shërbimeve publike” (nuk figuron në këtë strukturë) dhe përpara konstituimit të organit të qeverisjes vendore, Bashkia Shkodër sipas përcaktimeve të ligjit nr.115/2014, “Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, që e përcakton këtë të fundit si trashëgimtarin ligjor të njërive të qeverisjes vendore që janë shkrië në të, e cila, me konstituimin e organeve

përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ (*Për më tepër, sipas strukturës së miratuar me anë të Vendimit të Këshillit të Komunës nr.5, datë 04.03.2015 "Për miratimin e strukturës organizative për vitin 2015", punonjësit nuk figuronin në këtë strukturë*).

Në Njësinë Administrative Shosh

Njësia Përgjegjëse, pasi ka verifikuar plotësimin e kritereve ligjore për të qenë nëpunës civil të punonjësit ***** , bazuar në nenin 67 të ligjit nr.152/2013 "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, dhe në zbatim të rekomandimit të Komisionerit ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.1187/5, datë 01.10.2015, për këtë punonjës, në pozicionin "*Përgjegjës i Sektorit të Financës*".

➤ Njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, në zbatim të pikës 9 të vendimit të Komisionerit, ka anuluar aktet e konfirmimit si nëpunës civilë të punonjësve të Njësisë Administrative Rrethina, të cilët nuk kishin kryer trajnimin e detyrueshëm pranë Shkollës së Administratës Publike, kusht i përcaktuar në nenin 24 të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar, si më poshtë:

- Me aktin administrativ nr.1178/3, datë 01.10.2015, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër ka anuluar aktin e konfirmimit nr. 5, datë 20.04.2015, për punonjës *****. Me aktin nr. 416, datë 24.06.2016, "*Për lirim nga detyra*", kjo punonjëse është liruar nga detyra e "*Specialistit Nj.A Zyra me Një Ndalesë*" në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Bashkisë Shkodër me kërkesë të saj.
- Me aktin administrativ nr.1177/3, datë 01.10.2015, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër ka anuluar aktin administrativ të konfirmimit nr. 3, datë 20.04.2015, për punonjës *****,
- Me aktin administrativ nr.1190/6, datë 01.10.2015, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër ka anuluar aktin e konfirmimit nr. 8, datë 20.04.2015, për punonjës *****,
- Me aktin administrativ nr.1181/3, datë 01.10.2015, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër ka anuluar aktin e konfirmimit nr. 15, datë 20.04.2015, për punonjës *****.
- Me aktin administrativ nr.1182/3, datë 01.10.2015, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, ka anuluar aktin e konfirmimit nr. 10, datë 20.04.2015, për punonjës *****.

Pozicionet e mbajtura nga këta punonjës nuk figurojnë më në strukturën e Bashkisë Shkodër pas konstituimit të saj sipas përcaktimeve të ligjit nr.115/2014, "*Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë*", që e përcakton këtë të fundit si trashëgimtarin ligjor të njërive të qeverisjes vendore që janë shkrirë në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ.

- Në zbatim të pikës 10 të vendimit të Komisionerit, ku i lihej detyrë njësisë përgjegjëse që të anulonte aktet e emërimit dhe aktet e deklarimit të statusit të punësimit, të dala në kundërshtim me ligjin, si dhe të ndërpriste marrëdhënien e punësimit për punonjësit e njësive administrative Velipojë, Rrethina dhe Postribë, për shkak se fillimi i marrëdhënies së punës e këtyre punonjësve është bërë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, janë marrë masat e mëposhtme:

Në Njësinë Administrative Velipojë

- Njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, me aktin administrativ nr.221, datë 30.10.2015, ka vendosur lirim nga shërbimi civil për punonjësin ***** për shkak të ristrukturimit të institucionit. Njësia përgjegjëse ka gabuar kur ka vendosur si motivacion për largimin e këtij punonjësi nga shërbimi civil, procesin e ristrukturimit, pasi ai është emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Zyrës Juridike” në kundërshtim me ligjin, pa respektuar procedurat e konkurrimit. Largimi i punonjësit nga kjo detyrë ka kthyer gjendjen e ligjshmërisë në këtë rast, por njësia përgjegjëse në të ardhmen duhet të kujdeset që të respektojë me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.
Sa i takon aktit të deklarimit të statusit të punësimit nr.470, datë 28.04.2015, për punonjësin e mësipërm në detyrën “Jurist”, ai ka dalë në përputhje me përcaktimet e nenit 67, pika 3 e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Ai është emëruar në detyrën e mësipërme me Urdhrin nr.173, datë 03.10.2011, pra e përfiton statusin e punësimit për shkak të ligjit.
- Me aktin administrativ nr.1170/5, datë 01.10.2015, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, ka anuluar aktin e konfirmimit nr. 472, datë 20.04.2015, për punonjësen ***** sipas rekomandimit të vendimit të Komisionerit. Me aktin nr. 543, atë 01.08.2016, “Për lirim nga detyra”, punonjësja ***** është liruar nga detyra “Specialist i Ndhmës Ekonomike” në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike pranë Bashkisë Shkodër.
- Njësia Përgjegjëse në zbatim të vendimit të Komisionerit, me aktin administrativ nr.334, datë 30.10.2015, ka emëruar punonjësin ***** në pozicionin “punonjës mbështetës i shërbimeve publike”, pranë Bashkisë Shkodër, pozicion pune që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Mosrespektimi me korrektësi i rekomandimit të Komisionerit në këtë rast (ishte kërkuar anulimi i aktit të emërimit në pozicionin “Inspektor i Planifikimi”), duhet të mbahet parasysh nga njësia përgjegjëse për të mos u përsëritur më në të ardhmen.
- Me aktin administrativ nr.1169/3, datë 01.10.2015, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, ka anuluar aktin e konfirmimit nr. 471, datë 20.04.2015, për punonjësen ***** sipas rekomandimit të vendimit të Komisionerit Pozicioni i mbajtur nga kjo punonjëse nuk figuron më në strukturën e Bashkisë Shkodër pas konstituimit të saj sipas përcaktimeve të ligjit nr.115/2014, “Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, që e përcakton këtë të fundit si trashëgimtarin ligjor të njësive të qeverisjes vendore që janë shkrirë në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ.

- Me aktin administrativ nr.1172/3, datë 01.10.2015, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, ka anuluar aktin e emërimit të datës 20.04.2015, për punonjës in ***** sipas rekomandimit të vendimit të Komisionerit. Pozicioni i mbajtur nga ky punonjës nuk figuron më në strukturën e Bashkisë Shkodër pas konstituimit të saj sipas përcaktimeve të ligjit nr.115/2014, “Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, që e përcakton këtë të fundit si trashëgimtarin ligjor të njësive të qeverisjes vendore që janë shkrirë në të, e cila, me konstituimin e organeve përfaqësuese dhe ekzekutive, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet ekonomike, financiare, sociale apo të tjera, të karakterit civil dhe administrativ.
- Punonjësi ***** është emëruar me Vendimin nr.3, datë 15.04.2015 (nga Komuna Velipojë) dhe do të ushtronte funksionin “Inspektor Finance” përkohësisht deri në datën 31.08.2015. Me mbarimin e këtij afati, ka përfunduar edhe marrëdhënia e punësimit të këtij punonjësi, përpara konstituimit të njësisë së qeverisjes vendore, Bashkia Shkodër. Ky pozicion nuk ekziston më në strukturën e miratuar me Vendimin nr.93, datë 01.10.2015 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Shkodër, institucioneve të varësisë dhe shërbimeve publike”.
- Punonjësi ***** është emëruar përkohësisht me Vendimin nr.3, datë 15.04.2015 (nga Komuna Velipojë) dhe do të ushtronte funksionin “Përgjegjës i Sektorit të Planifikimit të Territorit dhe Kadastrës Urbane” deri në datën 31.08.2015. Me mbarimin e këtij afati, ka përfunduar edhe marrëdhënia e punësimit të këtij punonjësi, përpara konstituimit të njësisë së qeverisjes vendore, Bashkia Shkodër. Ky pozicion nuk ekziston më në strukturën e miratuar me Vendimin nr.93, datë 01.10.2015 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Shkodër, institucioneve të varësisë dhe shërbimeve publike”.
- Pozicioni “Drejtor i Marrëdhënieve me Publikun”, i mbajtur nga punonjësi ***** nuk ekziston në strukturën e Komunës Velipojë të miratuar me Vendimin nr.7, datë 20.03.2015, “Për miratimin e strukturës së administratës dhe të shërbimeve”, çka do të thotë se punonjësi ka ndërprerë marrëdhënien e punësimit përpara hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 93, datë 01.10.2015 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Shkodër, institucioneve të varësisë dhe shërbimeve publike” (përpara konstituimit të kësaj të fundit në përputhje me regjimin e ri juridik që solli ligji nr.115/2014, “Për Ndarjen Administrative-Territoriale të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”, në administrimin e qeverisjes vendore).

Në Njësinë Administrative Rrethina

Me aktin administrativ nr.1173/3, datë 01.10.2015, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, ka anuluar aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.01, datë 20.04.2014, për punonjës in ***** sipas rekomandimit të vendimit të Komisionerit. Me aktin nr. 626, datë 14.09.2016, “Për ndryshim vendi pune”, ky punonjës ka kaluar nga detyra Inspektor pranë Drejtorisë së Planifikimit dhe Regjistrimit të të Ardhurave me detyrë Evidencier në Njësinë e Ofrimit të Shërbimeve të Ndriçimit Publik,

pozicion pune jashtë shërbimit civil. Pavarësisht zbatimit jo korrekt të rekomandimit të Komisionerit në këtë rast, duke qenë se punonjësi në fjalë tashmë është larguar nga shërbimi civil, kjo detyrë e lënë në njësi të përgjegjëse do të konsiderohet e zbatuar, duke i tërhequr vëmendjen kësaj të fundit që në të ardhmen të zbatohet me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.

Në Njësine Administrative Postribë

Me aktin administrativ nr.1189/3, datë 01.10.2015, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, ka anuluar aktin e deklaramit të statusit të punësimit nr.3, datë 30.04.2015, për punonjësin *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës Sektori i të Ardhurave pranë Njesisë Administrative Postribë”, sipas rekomandimit të vendimit të Komisionerit. Me Urdhrin nr. 94, datë 02.10.2015, “Për emërimin në detyrë të Administratorit të Njesisë Administrative”, ky punonjës është emëruar si Administrator i kësaj njësie, pozicion pune që nuk përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil. Pavarësisht zbatimit jo korrekt të rekomandimit të Komisionerit në këtë rast, duke qenë se punonjësi në fjalë tashmë është larguar nga shërbimi civil, kjo detyrë e lënë në njësi të përgjegjëse do të konsiderohet e zbatuar, duke i tërhequr vëmendjen kësaj të fundit që në të ardhmen të zbatohet me përpikmëri ligjin dhe rekomandimet e Komisionerit.

Pozicionet e mësipërme nuk janë shpallur të lira pasi nuk ekzistojnë më në strukturën e miratuar me Vendimin nr.93, datë 01.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Bashkisë Shkodër, institucioneve të varësisë dhe shërbimeve publike”.

- Në zbatim të rekomandimit të pikës 11 të vendimit të Komisionerit, bazuar në VKM nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese” dhe VKM nr.243, datë 18.03.2015, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Shkodër me shkresën nr.253/3, datë 12.02.2016, si dhe nr. 254/3, datë 18.03.2015, ka bërë shpalljen për plotësimin e pozicioneve të lira sipas procedurave të ligjit për shërbimin civil.
- Njësia e Burimeve Njerëzore e Bashkisë Shkodër, në zbatim të rekomandimit të pikës 12 të vendimit të Komisionerit, ka vepruar si më poshtë:

Me aktin administrativ nr.1179/3, datë 01.10.2015, ka anuluar aktin nr.06, datë 20.04.2015, për statusin e nëpunësit civil për punonjësin *****, me detyrë “Përgjegjës Sektori”, pranë Njesisë Administrative Rrethina.

- Me aktin administrativ nr.1177/5, datë 01.10.2015, ka anuluar aktin nr.01, datë 20.04.2015, “Akti i Deklarimit të Statusit të Punësimit”, për punonjësin *****, me detyrë “Drejtor Drejtorie”, pranë Njesisë Administrative Rrethina, sepse akti i mësipërm ka dalë në kundërshtim me nenin 22 e vijues të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

- Me aktin administrativ nr.97, datë 20.03.2017, ka anuluar aktin nr.457, datë 10.04.2015, për deklarimin si nëpunës civil për punonjësen ***** me detyrë “Përgjegjëse e Zyrës Juridike”, pranë Njesisë Administrative Gur i Zi.
- Në zbatim të pikës 13 të vendimit të Komisionerit, në dosjet e personelit janë administruar për çdo nëpunës civil, aktet e deklarimit të statusit të punësimit të nxjerra në përputhje me nenin 67 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Po kështu dosjet e personelit janë plotësuar edhe me dokumentacionin e konstatuar të munguar (*raportet mjekësore dhe dëshmitë e penaltetit*). Dosjet janë plotësuar sipas përcaktimeve të pikës 6 të Kreut II të VKM nr.117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qëndror të personelit”.
- Njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër, në zbatim të pikës 14 të vendimit të Komisionerit, me Urdhrin nr.187, datë 02.10.2015, ka ngritur Komisionin e Ristrukturimit. Më tej, pasi ka verifikuar dosjet e punonjësve të ish Komunave, për ata punonjës që plotësonin kriteret për të qenë nëpunës civilë ka deklaruar statusin e punësimit, bazuar në nenin 67 të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ndërsa për punonjësit e tjerë të cilët nuk plotësonin kriteret e përcaktuara në nenin 21 të ligjit të mësipërm, ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punësimit, sikundër është analizuar më sipër në përmbajtjen e këtij materiali.
- ✓ Në zbatim të pikës 15 të vendimit të Komisionerit, me aktin administrativ, nr.1171/3, datë 01.10.2015, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër ka anuluar aktin e deklarimit të statusit të punësimit nr.474, datë 28.04.2015, për punonjësin ***** me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit të Territorit”. Aktualisht, nga komunikimi i këtij punonjësi me Komisionerin, rezulton se ai është sistemuar në pozicionin “Specialist në Sektorin e Zhvillimit të Projekteve të Brendshme” (pozicioni i cili përfshihet në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil), në Drejtorinë e Zhvillimit të Projekteve të Huaja, të Brendshme dhe Shpronësimeve, në Autoritetin Rrugor Shqiptar.
- Në lidhje me zbatimin e pikës 16 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse e Bashkisë Shkodër kishte hartuar dhe miratuar përshkrimet e punës, për pozicionet e shërbimit civil, në përputhje me legjislacionin specifik të fushës dhe formatin standard të miratuar, ashtu siç përcaktohet në Vendimin nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, ndryshuar me VKM nr. 262, datë 25.03.2015 dhe lidhjes nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe në Udhëzimin nr. 2, datë 07.04.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil”.
- Njësia përgjegjëse, bazuar në Vendimin nr.108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimi në shërbimin civil” dhe në zbatim të pikës 17 të vendimit të Komisionerit, me shkresën nr.664, datë 28.02.2017, “Plani vjetor i pranimeve në shërbimin civil për vitin 2017”, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ka bërë shpalljen e të gjitha pozicioneve të punës që janë zënë në kundërshtim me nenin

22 e vijues të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të cilat janë konstatuar në pjesën urdhëruese të vendimit të Komisionerit, si dhe ato që realisht janë të lira në strukturën organizative të miratuar me Vendimin nr.93, datë 01.10.2015, të Kryetarit të Bashkisë, “Miratimi i strukturës organizative të administratës së Bashkisë Shkodër, institucioneve të varësisë dhe shërbimeve publike”, të Kryetarit të Bashkisë Shkodër.

- Në zbatim të pikës 18 të vendimit të Komisionerit, njësia përgjegjëse kishte kryer procesin e vlerësimit të punës për vitin 2016, në përputhje me nenin 62 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil”.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin nr. 177 datë 30.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Shkodër”, të Komisionerit, rezultojnë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit janë bërë përpjekje për të zbatuar rekomandimet e vendimit të Komisionerit. Ashtu sikundër u evidentua edhe më sipër në përmbajtjen e këtij materiali, problemet apo parregullsitë e konstatuara në mënyrën e zbatimit të të këtij vendimi, duhet të mbahen parasysh nga njësia përgjegjëse për të mos u përsëritur më në të ardhmen.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit Bashkia Shkodër për zbatimin e Vendimit nr. 177 datë 30.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Shkodër”.
2. Për këtë vendim të njoftohet institucioni, Bashkia Shkodër dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA